



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-21/08-06

Prishtinë, më 20 dhe 21 prill 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Gazmend Muhaxheri** dhe **Xhavit HALITI**, anëtarë të Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 87 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë,

REND DITE:

1. Shqyrtimi i zbatimit të standardeve për Kosovën;
2. Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë dhe
3. Shqyrtimi i informatës së Qeverisë së Kosovës për parandalimin e gripit të shpezëve.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Teutë Hadri (PDK), propozoi që pika e tretë e rendit të ditës së kësaj seance të shtyhet për seancën e radhës, ngase nuk është e përgatitur.

Ramadan Kelmendi (LDK), kërkoi që Kuvendi në një seancë të veçantë të diskutojë për Mitrovicën.

Ramadan Musliu (LDK), paraqiti shqetësimet e dy fshatrave të komunës së Vitisë, Debëllde dhe Mjak, në kufi me Maqedoninë, të cilët pengohen për t'i punuar tokat e tyre dhe si pasojë e saj një numër i banorëve janë shpërngulur.

Sabit Rrahmani (PDAK), kërkoi që rendit të ditës t'i bashkëngjitet edhe propozimi për emërimin e anëtarëve të Grupit Parlamentar "Për Integrim" në komisionet parlamentare.

Xhevat Bislimi (PDK), propozoi që Kuvendi të miratojë një Rezolutë për rikonfirmimin e mos ndryshimit të kufijve të vendit.

Xhavit Haliti (PDK), kërkoi që të rishqyrtohet formula për zgjedhjen e anëtarëve të komisioneve parlamentare në përputhje me Kornizën Kushtetuese.

Teutë Sahatçija (ORA), deklaroi se mbështet kërkesën e Grupit Parlamentar "Për Integrim" për t'u përfshi në komisionet parlamentare.

Jakup Krasniqi (PDK), kërkoi informatë nga koalicioni qeverisës –LDK-AAK- se çka kanë bërë për bashkimin e qytetit të Mitrovicës?

Xhezair Murati (VAKAT), deklaroi se Grupi Parlamentar 6+ nuk është i gatshëm që vendet e veta në komisionet parlamentare t'ia liroj Grupit Parlamentar "Për Integrim".

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë propozimin e deputetes Teutë Hadri që të hiqet nga rendi i ditës pika e tretë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----40;

Kundër-----62.

Kryetari konstatoi: Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi propozimin e deputetes Teutë Hadri që të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance pika e tretë - Informata e Qeverisë për parandalimin e gripit të shpezëve.

1. Shqyrtimi i zbatimit të standardeve për Kosovën

Kryetari e ftoi kryeministrin e Kosovës t'i informojë deputetët e Kuvendit për zbatimin e standardeve për Kosovën.

Kryeministri **Agim Çeku** para deputetëve të Kuvendit paraqiti aktivitetet e Qeverisë së Kosovës në fushën e zbatimit të standardeve për Kosovën. Deri tani janë bërë katër vlerësimet e standardeve nga UNMIK-u, që paraqesin zhvillimet dhe rezultatet që Qeveria e Kosovës i ka arritur që nga mesi i vitit 2004 e deri në dhjetor të vitit 2005, theksoi kryeministri.

Sot gjendemi në proceset e reja që janë mundësuar pikërisht si rezultat i progresit të standardeve. Standardet edhe sot mbesin të rëndësishëm për Kosovën, andaj edhe janë dhe do të mbeten prioritet i Qeverisë. Janë bërë disa ndryshime në strukturat dhe mekanizmat e veprimit, do t'i cek disa:

Ministria e sapokrijuar e Drejtësisë i ka marrë përsipër standardet e sundimit të ligjit, kurse Ministria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për plotësimin e standardit për funksionimin demokratik të institucioneve.

Çdo dy javë kemi takime të rregullta me të gjithë kryesuesit e grupeve të punës të Qeverisë dhe të UNMIK-ut për standardet.

Çdo muaj do të kemi takime të rregullta me kryetarët e komunave.

Çdo tri javë secili grup pune për standarde edhe më tutje raporton në zyrat ndërlidhëse të UNMIK-ut, si dhe përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë, për shkallët dhe për progresin e standardeve.

Po i përmendi vetëm disa nga veprimet dhe rezultatet e arritura në periudhën e fundit:

Krijimi i Agjencisë për pronën do t'u japë fund uzurpimeve të pronave komerciale dhe atyre bujqësore; Krijimi i dy ministrive të reja; Gurthemeli për shtëpitë e banorëve të lagjes së romëve të Mitrovicës; Është arritur sukses në rritjen e komunikimit me komunat veriore në takimet e përbashkëta; Është rritur kontrolli dhe transparenca në të gjitha institucionet qendrore dhe lokale; Është rritur dhe do të rritet edhe më shumë lufta kundër dukurive negative në institucione.

Zyra e Prokurorit Special, e cila është në fazën përfundimtare të krijimit bashkë me Agjencinë Antikorrupsion, do të jenë mbështetje e fuqishme e Qeverisë për politikën e saj të re, zero tolerancë kundër krimit dhe korrupsionit.

Progres është arritur në fushën e avancimit të disiplinës fiskale në proporcion dhe duke iu përmbajtur marrëveshjes së arritur me institucionet financiare ndërkombëtare.

Të gjitha standardet janë të rëndësishme, por faza në të cilën gjendemi, megjithatë kërkon nga ne një fokus më të madh dhe orientim në përmirësimin e pozitës së minoriteteve. Orientimi ynë paqësorë në implementimin e standardeve do të jetë edhe më tutje në ofrimin dhe avancimin e pozitës së minoriteteve, si dhe krijimin e besimit në procesin që po kalon Kosova.

Standardet për Kosovën janë një sfidë e konsiderueshme që kërkon përkrahje dhe bashkëpunim nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Puna jonë në implementimin e standardeve dhe krijimi i një Kosove demokratike, tolerante me një ekonomi të qëndrueshme nuk ka përfunduar dhe do të vazhdojë dhe pas vlerësimit të Këshillit të Sigurimit në muajin qershor dhe pas përcaktimit të statutit politik të Kosovës.

Kryetari e hapi shqyrtimin.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e përgëzoi Qeverinë e Kosovës për rezultatet e arritura në fushën e zbatimit të standardeve për Kosovën. Grupi ynë riafirmon përcaktimin dhe përkushtimin për angazhim me mbështetje të programit të realizimit të plotë të standardeve për Kosovën për një Kosovë të pavarur, për një Kosovë evropatlantike.

Hashim Thaçi - paraqiti qëndrimet dhe vlerësimet e Partisë Demokratike të Kosovës për punën e Qeverisë së Kosovës në fushën e zbatimit të standardeve.

Në vazhdim, deputeti Thaçi theksoi se PDK-ja përkrah dhe punon që Kosova të ketë institucione funksionale, stabile dhe demokratike. Ky standard është bazë për zhvillimin e shoqërisë sipas modelit të demokracisë qytetare, por standardet janë shndërruar në dekor dhe blerje kohe nga qeveritarët aktual.

Ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme tashmë se emërimi i ministrave dhe kryeministrave është bërë nga struktura para politike. Ata nuk i japin llogari këtij Kuvendi, as Qeverisë, por i japin llogari para politikës - atyre që i kanë zgjedhur dhe emëruar.

Standardi i sundimit të ligjit mund të rrimëtohej lirisht standardi i sundimit dhe i tolerimit të krimit të organizuar nga Qeveria aktuale.

Korrupsioni në Qeverinë aktuale është rrezik për pavarësinë, sigurinë, pengesë për zhvillimin ekonomik, kërcënuese për demokracinë në Kosovë dhe integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Procesi i privatizimit po përcillet me afera korrupsioni dhe komplikime të tjera.

Partia Demokratike e Kosovës dhe spektri i gjerë politik paraqesin ofertë për dalje nga kjo krizë politike dhe institucionale, për ta formuar një qeveri me mbështetje të gjerë politike, qeveri të ekspertëve deri në zgjedhjet e ardhshme. Kjo qeveri profesionale do ta çonte vendin drejt pavarësisë së plotë.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se vlerësojnë lart Qeverinë Haradinaj, që i vuri standardet në prioritet të angazhimit të sajë dhe pas 100 ditëve mori vlerësime shumë të larta pozitive si nga vetë në vendorët, gjithashtu edhe nga ndërkombëtarët në procesin e implementimit të standardeve.

Vlerësojmë lart Qeverinë Kosumi në vazhdimin e procesit të implementimit të standardeve, raporti i Kai Aidës dhe fillimi i mbarë e në kohë i procesit të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës.

Çmojmë përkushtimin e Qeverisë Çeku dhe angazhimet në implementimin e standardeve, duke i kuptuar ato si standarde për ta rritur dhe për ta ngritur mirëqenien, por edhe për të përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

Grupi Parlamentar i AAK-së i hedh poshtë të gjitha supozimet dhe vlerësimet e Grupit Parlamentar të PDK-së, të shprehura këtu nga z. Thaçi.

Veton Surroi, në emër të Partisë Reformiste ORA, theksoi se standardet për Kosovën janë kuptuar në formë mekanike, pa kurrfarë përmbajtje.

Pjesa tjetër është në përmbajtje. Të shohim se çfarë është qasja e Qeverisë ndaj sundimit të ligjit.

Qasja e Qeverisë në sundimin e ligjit është fakti se është formuar Ministria e Drejtësisë. Por, janë botuar raportet e auditorëve të shumë agjencive shpenzuese të buxhetit të Kosovës dhe në të gjitha këto raporte ekziston fenomeni i keqmenaxhimit, i keqpërdorimit të parasë publike. Nuk është shkarje, keqmenaxhimi është normë e sjelljes, është kulturë qeverisëse.

Ekzistojnë dy forma të qasjes në të ardhmen. Ekzistojnë ato që quhen kritere të Kopenhagës, që janë kritere që çdo shtet evropian duhet t'i përmbushë, në mënyrë që të fillojë procesi i integritimit në Bashkimin Evropian. Dhe qasja e dytë, është pyetja e qytetarit - Çka është ajo që ndryshon në jetën time si qytetar nëse zbatohen, ose nuk zbatohen standardet?

Nëse vlerësohet nga kuti matës i qytetarëve të rëndomtë, atëherë do të shihni se pak, ose hiq, është bërë për standardin e tyre. Gjendja në arsim, në shëndetësi, në sistemin

pensional dhe në fusha të tjera të qytetarëve të Kosovës është më e keqe se sa ka qenë para 20 vjetësh.

Ky është një shtet që nuk funksionon në aspektin e vet ekonomik dhe është shtet që për më tepër nuk ka politikë ekonomike.

Numan Baliq, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim” tha se zbatimi i standardeve i përket gjithë shoqërisë së vendit, por do të përqendrohem më tepër në fushën e pakicave. Në vazhdim, deputeti Baliq shtroi dilemën e funksionimit të institucioneve të Kosovës, ngase në krye të tyre ka njerëz që nuk janë kompetentë për punët që i ushtrojnë. Për të punësuarit në shërbimin civil të institucioneve nuk ka informacione të mjaftueshme se sa për qind e pjesëtarëve të komunitetit boshnjak, romë dhe ashkalinjë janë të punësuar dhe në cilat pozita udhëheqëse?

Në sistemin e gjyqësisë shumë raste të dhunës ndaj bashkësive joshqiptare pas vitit 1999 ende nuk janë zbuluar. Ka raste që pronat e uzurpuara ende nuk u janë kthyer pronarëve të ligjshëm.

Një numër i madh i të shpërngulurve, të përkatësisë boshnjake, rome dhe egjiptase ende nuk janë kthyer, për të cilët duhet të vlejnjë të njëjtat kritere si për të shpërngulurit e tjerë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me zbatimin e standardeve për Kosovën dhanë edhe këta deputetë: **Ramadan Kelmendi, Sanije Aliaj, Emrush Xhemajli, Nexhat Rexha, Gjylnaze Sylja, Xhezair Murati, Naxhije Doçi, Sala Ahmetaj, Jonuz Kastrati, Shaban Halimi, Nimon Alimusaj, Berat Luzha, Bislim Hoti, Nazim Jashari, Ymer Halimi, Xhevat Bislimi, Safete Hadërgjonaj, Mazllun Kumnova, Hajredin Kuçi, Fatmir Rexhepi, Myrvete Dreshaj, Xhevdet Neziraj, Teutë Sahatçija, Jakup Krasniqi, Hajredin Hyseni, Xhelal Canziba, Fatmire Mulhaxha, Bajrush Xhemajli, Ylber Hysa, Zylfije Hundozi, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Haki Shatri, Bujar Dugolli dhe Fetah Berisha**, që janë pjesë përbërëse e transkriptit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi: **Kuvendi i Kosovës miratoi raportin e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e standardeve për Kosovën , me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve.**

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 19:25 minuta.

Vazhdimi i seancës

Më 21 prill 2006

Të pranishëm ishin 82 deputetë.

Seancën e kryesoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

2. Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë

Kryetari e ftoi shefin e shtyllës së katërt të UNMIK-ut t'i informoi deputetët e Kuvendit për rrjedhat e privatizimit në Kosovë.

Shefi i shtyllës së katërt të UNMIK-ut, z. **Joakim Ryker**, paraqiti para deputetëve të Kuvendit të arriturat e AKM-së për procesin e privatizimit në Kosovë.

Në vazhdim, z. Ryker theksoi se ky proces është me të vërtetë vendimtar për ekonominë e Kosovës, e cila është ende në rrethin vicioz të zhvillimit të ulët, papunësia e lartë, një çekuilibër i madh dhe përmbajtje fiskale. Rruga e vetme për të dalë nga ky rreth vicioz është nëpërmjet zhvillimit të fuqishëm të sektorit privat, duke tërhequr investimet e fuqishme në këtë sektor .

Procesi i privatizimit fiton nga përvoja e mbledhur nga ekonomitë e transformuara. Sa i përket pronësisë ose kërkesave kreditore, ne e ndjekim parimin “kompensim, por pa dëmshpërblim fizik”, sipas Kartës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilës i referohet Rregullorja e AKM-së. Ne punojmë me maturi të instrumentit të Spinoff-it Special, të kushteve të veçanta të tenderit.

Gjatë mandatit tim , si kryesues i Bordit të AKM-së, nuk di për ndonjë shkelje as materiale as të Rregullores së AKM-së, as të politikave operacionale të AKM-së. Të gjithë fituesit e tenderëve të përkohshëm janë të kontrolluar nga Shtylla I e UNMIK-ut përpara se të bëhen fitues real të tenderëve.

Në prill të vitit 2005 , procesi i privatizimit në Kosovë ishte ndalur. Ishin përfunduar vetëm 2 valë të privatizimit, kurse tani kemi një gjendje më të mirë.

Pasqyra e programit të privatizimit tregon se:

Të ardhurat e tërësishme për Spin-off, të paguara apo që pritet të paguhet janë përafërsisht 160 milion € . Nëse të gjitha zotimet respektohen, deri më sot do të ishin mbledhur rreth 240 milion € nëpërmjet tenderëve gjatë programit të privatizimit.

Është e njohur se hapja e ofertave për ndërmarrjet e rëndësishme siç janë: Hoteli „Grand”, Verërraria „Rahoveci”, „Ramiz Sadiku” Hotel „Iliria” dhe BIRRARIA e Pejës është bërë kohëve të fundit dhe jemi duke punuar në përfundimin e këtyre shitjeve.

Më lejoni të theksoj disa çështje që luajnë rol në debatin politik të privatizimit.

Së pari, kërkesa për të investuar paratë e Fondit të Mirëbesimit të fituara nga të ardhurat e privatizimit ekskluzivisht në Kosovë. Është e qartë se natyra e Fondit të Mirëbesimit nuk i jep të drejtën të besuarit, AKM-së, që t’i japë këto të holla, p.sh. për BKK.

Së dyti, jemi pyetur pse nuk i privatizojmë së paku disa pjesë të NP. Përgjigjja për këtë është shumë e thjeshtë: Kjo nuk është në mandatin tonë. E gjithë ajo që mund ta bëjmë nën mandatin e tanishëm është t’i përgatisim NP-të për privatizim të mundshëm pas statusit.

Lidhur me Trepçën , AKM-ja është në dijeni për dimensionin politik dhe shoqëror të kësaj ndërmarrjeje shoqërore mjaft të rëndësishme. Mu për këtë shkak , në pajtim me Qeverinë, ne kemi ndjekur një strategji tridegëshe.

- Të mbrojmë Trepçën nga pretendimet e mëdha të kreditorëve;
- Të fillojmë prodhimin kudo që të jetë e mundshme, në mënyrë që të krijojmë punësim dhe të hyra;
- Të përgatisim një strategji të drejtë të privatizimit eventual.

Në fund dëshiroj të jap një komentim të kërkesave lidhur me transferin e pjesshëm apo të tërësishëm të AKM-së në IPVQ. Ky proces do të zgjatej aq shumë sa që me siguri që më parë do të vendosej statusi i Kosovës sesa të përfundonim ne procesin e transferit. Për shkak të kësaj, rekomandoj të përqendrohemi në atë që do të mund të quhet një

përfundim i arsyeshëm i punës së privatizimit të periudhës së vitit 2006. Pra , 90% të vlerave dhe 50% të numrit të ndërmarrjeve shoqërore tashmë janë realizuar. Pas kësaj, po qese statusi ende nuk është zgjedhur, ne mund t'i rikthehemi projektit të transferit. Periudha pas statusit është një çështje krejtësisht tjetër.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë që në emër të Qeverisë së Kosovës t'i informojë deputetët e Kuvendit për procesin e privatizimit.

Ministri **Bujar Dugolli** tha se Qeveria e Kosovës ka vazhduar me buxhetin e saj t'i financojë programet e privatizimit që nga fillimi dhe janë qindra miliona që ka derdhur për këtë proces.

Pavarësisht se i ndajmë të gjitha këto mjete për proces, por edhe më tutje nuk mund ta kontrollojmë qind për qind këtë proces dhe se procesi i privatizimit vazhdon të mbetet po ashtu pjesë e rezervuar dhe ne mendojmë se tani ka ardhur koha që ne të mendojmë seriozisht për transferin e kompetencave në këtë fushë.

Nuk ka diskutim se në këtë proces kanë ndodhë ndryshime pozitive, ardhja e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm z. Petersen , edhe zotit Rosin dhe posaçërisht shefit të Shtyllës së Katërt z. Joachim Ruecker, krijuan te faktori ndërkombëtar te UNMIK-u një klimë krejt tjetër të re, sa i përket këtij procesi, dhe këta u angazhuan të zhblllokohet ky proces. Ky proces pozitiv që ka ndodhur deri më tash nuk do të mund të merret me mend pa pasur një qasje pozitive dhe një punë të suksesshme të institucioneve të Kosovës, në veçanti të Qeverisë nëpërmjet anëtarëve të saj në Bordin e AKM-ës.

Bordi i AKM-së, bord i ri që filloi tash një vit punën, filloi t'i evitojë ato pakënaqësi që ishin shfaqur në opinion dhe në vetë punën e bordit . Ne arritëm t'i bëjmë disa ndryshime në politikat operacionale që ishin pengesë e një zhvillimi të shpejtë. Ne bëmë disa ndryshime. Dua ta përmend një që ishte shembull në Spin-ofet e rregullta ku lejonte dy raste ofertimi të bëhen për shitjen e një ndërmarrjeje me spinof të thjeshtë që ishte edhe e rëndë, por edhe e mundimshme edhe nuk ishte efektive.

Ne filluam punën përveç procesit të privatizimit u bë korporatizimi i ndërmarrjeve publike si Posta, Telekomunikacioni, Aeroporti i Prishtinës, KEK-u, Hekurudha, Ngrohtorja e Prishtinës. U tenderuan dhe u privatizuan 230 ndërmarrje të reja vetëm në 12 valët e privatizimit, pastaj edhe 70 ndërmarrje të reja u tenderuan në valën e 13, 14, 15 që nënkupton 300 ndërmarrje të reja do të privatizohen- d.m.th. me rrumbullaksim e 15 valëve të privatizimit.

Unë dua t'i përmend disa veprime që për ne nuk janë të kënaqshme në këtë proces. Vonesa në zgjedhjen e lëndëve nga Gjykata e Lartë Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme është diçka që ka dështuar.

Vonesat në pagesën e 20% të punëtorëve, po ashtu është edhe një dështim, mos zhblllokimi i fondit të privatizimit, vonesat e kontrollit financiar që bëhen nga Shtylla e katërt.

Tërheqja e investitorëve nga gara mund të konsiderohet dështim, por nuk kemi mundësi t'i obligojmë të mos tërhiqen.

Si përfundim mund të them që shtytja që ia dha këtij procesi qasja e re pozitive e udhëheqësve të UNMIK-ut z. Petersen dhe z. Kuecker, angazhimi i Qeverisë së Kosovës dhe agjencitë donatore si USAID-i , AER-i pjesëmarrëse në cilësinë e vëzhguesit në

Bordin e AKM-ës, ishin disa elemente shumë të rëndësishme që e zhblokuan këtë proces. Ne mund të themi që gjatë këtij viti patëm një sukses.

Pas referimit të shefit të shtyllës së katërt, z. Joahim Ryker dhe të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë. Z. Bujar Dugolli, kryesuesi e hapi diskutimin për rrjedhat e procesit të privatizimit.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se gjatë procesit të privatizimit duhet të ketë më shumë transparencë. Ai kërkoi që të fillojë një auditim i përgjithshëm për procesin e privatizimit në Kosovë dhe me rezultatet e atij auditimi të njihet KS i OKB-së.

Të formohet Agjencia e privatizimit për pjesën e mbetur të NSH-ve.

Kuvendi ,në një seancë të veçantë, të diskutojë për Trepçën.

Jakup Krasniqi , tha se Grupit Parlamentar i PDK-së shpreh pakënaqësi për procesin e privatizimit në Kosovë.

Ai kërkoi që mjetet e grumbulluara nga privatizimi, të cilat mbahen të bllokuara, të angazhohen për zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Qeveria e Kosovës ta hartojë strategjinë për pasuritë kombëtare, që nuk duhet të përfshihen në procesin e privatizimit. Qeveria të mbetet aksionare në ato NSH që i ka kredituar nga buxheti i saj.

Të ndryshohen politikat operacionale, si dhe të korrigojë Rregullorja për privatizim.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështetë raportin e ministrit Dugolli.

AKM-ja nuk gëzon kredibilitet të mjaftueshëm, ngase merr mjete të konsiderueshme nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, por nuk i raporton Kuvendit të Kosovës.

Duhet të zhblokohen mjetet e privatizimit.

Ndryshimet në NSH gjatë viteve të 90-ta, me masat e dhunshme, të mos njihen me rastin e privatizimit.

Procesi i privatizimit të jetë më transparent, kurse Bordi i AKM-së më serioz, ngase fabrikat po shndërrohen në vetëshërbime, kurse toka bujqësore në tokë ndërtimore.

Veton Surroi, në emër të Partisë reformiste ORA, tha se raporti i ministrit Dugolli nuk ishte analitik. Ai ngriti disa çështje lidhur me rezultatet e privatizimit. Sa ka ndikuar privatizimi në rritjen e shkallës së punësimit? Sa ka ndikuar procesi i privatizimit në ndryshimin e strukturës të industrisë së vendit? Sa ka pasur efekt në shtimin e parasë?

Qeverisë i adresohen:

- Asetet strategjike,
- Ngrirja e parasë publike dhe
- Korporatizimi. Kush është aksionar i atyre ndërmarrjeve?

Mjetet nga fondi i privatizimit të NSH-ve mund të derdhen në Fondin e pensioneve të Kosovës, për pagesat e pensionistëve.

Ekziston sot një shpërputhje mes dekapitalizimit dhe kapitalizimit. Kjo është kriza më esenciale të cilën do ta shohim në procesin e privatizimit. Ndërmarrësit e lirë do të blejnë, nuk do të kenë para për të riaktivizuar, sepse paraja është e shtrenjtë.

Kosova nuk ka bankë qendrore, pra nuk ka autoritet a institucion, i cili do të jetë një lloj arbitri në këtë treg financiar. Për të gjitha këto nevojitet një koncept i ndërtimit.

Privatizimi e ka përkrahjen tonë elementare, por nuk e ka njohurinë se brenda çfarë koncepti qeverisës është futur.

Xhezair Murati, në emër të grupit Parlamentar 6+, tha se për procesin e privatizimit në Kosovë nuk është gjetur modeli i duhur, që i përgjigjet rrethanave tona. Mjetet nga privatizimi i NSH-ve nuk janë përdorur për zhvillimin e vendit. Nuk ka politikë sociale adekuate karshi gjendjes që është në shoqërinë tonë.

Privatizimi duhet të jetë më transparent për qytetarët e Kosovës.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim” tha se procesi i privatizimit nuk e ka rritjen e punësimit, përkundrazi është rritur shkalla e papunësisë. Ai këtë e ilustroi me rastin e NSH “Printeks” të Prizrenit, ku blerësi i saj ka filluar ta shesë atë pjesë, pjesë, kurse punëtorët kanë mbetur rrugëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë dhanë edhe këta deputetë: **Sadudin Berisha, Safete Hadërgjonaj, Shaban Halimi, Brikenda Kryeziu, Naser Osmani, Fadil Gashi, Mazllun Kumnova, Zef Morina, Ilmi Ahmeti, Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Genc Gorani, Myrvete Dreshaj, Behxhet Brajshori, Nekibe Kelmendi, Afrim Arzuallxhiu, Ymer Halimi, Nazim Jashari, Sala Berisha, Ymer Muhaxheri, Berat Luzha, Hatixhe Hoxha, Bislim Hoti, Teutë Sahatçija, Hajredin Kuçi, Xhevat Bislimi, Fetah Berisha, Xhevdet Neziraj, Hajredin Hyseni, Sabit Rrahmani dhe Gani Koci**, e që i janë pjesë përbërëse e transkriptit.

Në fund të debatit, shefi i shtyllës së katërt, z. **Ryker** dhe ministri Bujar **Dugolli** iu përgjigjen pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi: **Kuvendi i Kosovës miratoi raportin dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës për procesin e privatizimit në Kosovën me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve.**

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 17:30 minuta.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
